



VENDIM
Nr.13 Datë 08.02.2010

PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“SELCA ENERGJI” SH.P.K.

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.02.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SELCA ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “a”)
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa a,b,c,d,f dhe g) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “b”)
- o Dokumentacioni finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “c”)
- o Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4) eshte plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “d”).

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “SELCA ENERGJI” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Selca.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta

